

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje dhe vendosje kamera sigurie per shkollat, Bashkia Puke

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kamera sigurie 35125300-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,613,150 (Nje milion e gjashtëqinde e trembedhjetemije e njeqinde e pesedhjetete) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. a. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë* “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për **të paktën një nga vitet** e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. *Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqese: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 40% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës së fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3. a. Furnizime të ngjashme me një vlerë **me një vlerë jo më të vogël** se 20 % të **te vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit për permbushje me sukses të kontratës të shoqëruar me kontratën e lidhur me Autoritetin Kontraktor dhe Operatorin Ekonomik

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit për këtë objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedurë vendoset për të demonstruar që op. ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op. ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1. operatorin ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi të op. ekonomik, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet të ketë secili subjekt në vetë

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetin Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i

ndryshuar.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632,datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ose me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë / certifikatë kualifikimi nga institucione të akredituara stafin e mëposhtëm:

- a) 1 (një) Inxhinier elektronik / IT
- b) 1(një) teknik fibrash optike
- c) 1 (një) punonjës për montimin e kamerave të pajisur me dëshmi kualifikimi

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ku te deklarojnë dhe numrat e kontratave te punes dhe datat me specialistet perkates

Argumentim : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kapacitet teknike si dhe stafin për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Instalimi/konfigurimi/mirëmbajtja e këtij sistemi ndahet në disa aspekte teknike ku janë të nevojshëm specialist në fushën përkatëse si më poshtë :

Installimet e rrjetit, ngjitjet dhe lidhjet si dhe pajisjet elektronike si kamera kërkojnë inxhinier të posaçëm të cilët normalisht janë pjesë e fushës së Elektronikes/Kompjuterike. Duke patur parasysh shtrirjen gjeografike ku do të montohen kamerat në shkollat e Bashkisë Puke dhe Njësi Administrative, numrin e pajisjeve dhe kohën në dispozicion kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e ofertuesve të një inxhinieri të sipërcituar, është një kërkesë minimale për të siguruar ecurinë e procesit dhe për të garantuar AK për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Po ashtu duke parë që kamerat duhet të lidhin me internet me shpejtesi të larte që të jone eficente kerkojet dhe tekniku për ibrat optike ku eshte kerkuar minimumi 1 për të garantuar konkurrence,po ashtu eshte kerkuar dhe 1 punonjes për montimin e kamarave i pasiuur me deshmi që garanton kryerjen e sherbimit me cilesi por dhe me siguri teknike.

2.3.3-Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributor të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi, I cili duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit, si telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

2.3.4-Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

- 1 IR PTZ AI Network Camera – 2 vite
- 2 Kamera IP 8MP Bullet WDR – 2 vite
- 3 Kamera IP 6MP Bullet Motorized WDR – 2 vite
- 4 Active Deterrence 5 MP IP Full Color Camera – 2 vite
- 5 IRLZF Kamera ANPR – 2 vite
- 11 PDU Power Distributor Unit – 2 vite
- 26 Bateri 100 A e thate – 2 vite
- 27 Inverter 500 W ne pikat e vendosjes se kamerave – 2 vite
- 28 Inverter 3000 W – 2 vite
- 29 Bateri 200 A e thate – 2 vite

2.3.6 Operatori ekonomik në datën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për artikujt si më poshtë:

- 1 IR PTZ AI Network Camera
- 2 Kamera IP 8MP Bullet WDR
- 3 Kamera IP 6MP Bullet Motorized WDR
- 4 Active Deterrence 5 MP IP Full Color Camera
- 5 IRLZF Kamera ANPR
- 7 Hard Disk me Kapacitet 10TB
- 8 Switch 8-Port PoE 96 Watt
- 12 Kabllo UTP Cat6 (me meter linear)
- 22 HDMI 10m
- 23 Fiber Optike
- 26 Bateri 100 A e thate
- 27 Inverter 500W në pikat e vendosjes se kamerave

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin mostra të mallrave të kërkuar nga AK. **Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-sëNr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se:**

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu janë perzgjedhur zërat e preventivit që kanë peshe specifike me të madhe në preventive.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit arsyeton se është e rëndësishme për autoritetin kontraktor kërkesa për mostrat për 1 (një) kamer. Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i kontratës me sukses dhe në kohë, duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Bazuar mbi legjislacionin në fuqi, njësia e prokurimit gjykon se është më efiçase për autoritetin kontraktor garancia se ofertuesit disponojnë mallrat objekt prokurimi përpara dhënies së kontratës duke paraqitur mostrat përkatëse në përputhje me specifikimet teknike në datën e përcaktuar nga ky i fundit.

Duke u nisur edhe nga përvojat e mëparshme për procedurat e nisura nga autoriteti kontraktor të cilat kanë rezultuar efiçase në të gjitha rastet kur janë kërkuar mostrat të mallrave objekt prokurimi në përputhje me përcaktimet e nenit 40, pika 6 gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, janë zbatuar kontratat me rigorozitet, cilësi dhe në kohë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që do të kryejë furnizimin dhe vendosjen e mallrave të kërkuar në një afat kohor prej 30 ditësh kalendarike.

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë shërbim, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për mënyrën e përlllogaritjes të vlerës së prokurimit bazuar në nenin 76 të VKM 285 date 19.05.2021.

Sa i përket respektimit të pikës “a”, grupi i Punës ka kontrolluar në faqen zyrtare Institutit të Statistikave (INSTAT), për të marre informacion mbi çmimet për objekt” duke specifikuar të dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre artikujve që Autoriteti Kontraktor “DPPGJ” kërkon. INSTAT nuk disponon çmime të botuara për këte lloj procedure.

- **Sa i përket respektimit të pikës “c”, grupi i Punës nuk mund të marrë si shembull çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara pasi nuk është realizuar ndonjëherë një shërbim apo blerje e tillë.**

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje malli, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

- ❖ **Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të liçensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare**

on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.

Grupi i punës ka kontaktuar me këto subjekte që operojnë në treg, për marrjen e ofertave. Format e komunikimit me subjektet e tregut kanë qenë ato të parashikuara në ligj dhe konkretisht me nëpërmjet postës elektronike, në varësi të rrethanave dhe mundësive reale të komunikimit. Subjektet që veprojnë në këtë sektore, janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike të kërkesave tona, për sa i përket, dhe identifikimit të artikujve në treg, në mënyrë që këta të fundit të kishin mundësi të analizonin dhe të jepnin ofertat e tyre të përafërta, grupi i punës ka marrë në treg 3 (tre) oferta ekonomike.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësi e prokurimit sipas profesioneve që kanë ku specialistet e it kanë hartuar sasine e mallit specifikat si dhe kriteret teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar

Njesia Prokurimit